



UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 105 të Statutit të Universitetit të Tetovës, komisioni universitar i zgjedhjeve, më 14 qershor 2023 solli këtë

Nr. / бр. 02-1677/1  
Tetovë/Tetovo,  
14.06 2023 г.  
Universiteti i Tetovës/  
Универзитет во Тетово  
Rektorat, rr. Ilindenit, рп/  
Ректорат, ул. Илинденска - 66  
1200, Tetovë/Tetovo

## AKTVENDIM

pas ankesës së prof. dr. Dervish Alimit për Vendimin për përcaktimin e listës së kandidatëve për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës për mandatin 2023-2026

### Neni 1

Refuzohet Ankesa e prof. dr. Dervish Alimit për Vendimin për përcaktimin e listës së kandidatëve për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës për mandatin 2023-2026, për shkak se është e pabazë.

(1) Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

### ARSYETIM

Prof. dr. Dervish Alimi, kandidat për rektor i Universitetit të Tetovës për mandatin 2023-2026, parashton ankesë të paarkivuar në komisionin universitar të zgjedhjeve, në të cilën tregon kushtet për ndërprerjen e mandatit të rektorit për shkak të pensionimit. Nga pretendimet e paqarta të theksuara në ankesë, dhe në pajtim me nenin 108 paragrafi (1) pika 3, e jo nenin 113 siç është cekur në ankesë, është vërtetuar qartë se një nga kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të rektorit është përmbushja e kushtit për pensionim.

Nga e lartpërmendura, nëse mund të kuptohet qëllimi i ankesës, për dyshime të mundshme për kandidatët, KUZ-ja konfirmon se të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në bazë të konkursit publik dhe janë pjesë përbërëse e listës së kandidatëve për zgjedhjen e rektorit janë në marrëdhënie pune në Universitetin e Tetovës. Kësisoj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Vendimi i KUZ-së është i formës së prerë dhe kundër tij mund të ngrihet padi në gjykatën administrative në përputhje me ligjin.

Kryetari i KUZ-së,

Prof. dr. Nderim Zeqiri

